



REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 2470/1 Prot.

Tiranë, më 08/10 /2024

V E N D I M

Nr. 12, datë 08.10.2024

PËR

**MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË FORMATIT TË DIPLOMËS SË GRADËS
SHKENCORE “DOKTOR”, NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS**

Mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në Udhëzimin e MAS Nr. 14, datë 21.06.2022, Për disa ndryshime në Udhëzimin Nr. 10, datë 30.03.2020 “Për përcaktimin e elementeve përbërës, formën e diplomës ose certifikatës të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë dhe procedurës së regjistrimit të tyre në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor”, në relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Kërkimit Shkencor dhe Projekteve me Nr. 2470 Prot., datë 04.10.2024, Senati Akademik në mbledhjen e datës 08.10.2024,

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimet në formatin e diplomës për programin e ciklit të tretë të studimeve “Doktoratë”, në Universitetin Politeknik të Tiranës.
2. Formati i Diplomes së Gradës Shkencore “Doktor” i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë,

KRYETARI

Prof. Dr. Akli Fundo


